



Shfaqja "Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës" e autorit Jeton Neziraj dhe regji të Blerta Neziraj

Foto: Avni Selmani

## në vetëm artistët"

për vetë teatrin. Në rastin tonë, ajo madje luhet edhe vetë në teatër. Natyrisht që shfaqja ("Fluturimi...") që një konflikt mes qeverisë aktuale dhe kompanisë Qendra Multimedia dhe një sfidë për mjedisin politik. Por konfliktet e negociuara janë universale. Gjithkund politika orvatet ta përvetësojë artin për qëllime reprezentative, qoftë direkt apo indirekt. Qoftë përmes festivaleve me aktivitete falas për elektoratin apo përmes tumeve jashtë vendit të mbështetura nga shteti, e që gjithmonë fjala është për fitim të imazhit. Shembulli i Francës: Askund tjetër nuk ka aq shumë festivale të artit rugor të zhvilluara fort dhe me pretendime të larta artistike. Institut Français organizon ekzibicionet e kreacionit bashkëkohor në vallëzim, cirk të ri apo performanca teatrore. Artisti i veçantë dëshiron të ndihet i lirë dhe i pandikuar gjatë një kreacioni, mirëpo kompeticionet ndërkombëtare e dëshmojnë edhe ndikimin subtil, afatgjatë të mbështetjes shtetërore ndaj tij dhe estetikës zhvillimore aktuale. Por, kjo nuk do të thotë mungesë e kritikës ndaj klasës politike ose ndaj çështjeve konkrete. Në anën tjetër, perceptimi i një shoqërie si e aftë për kritikë, dhe në gjendje që të ripërtërihet duke dalë nga vetvetja, është e një rëndësie enorme. Në këtë mënyrë edhe artistëve u takon që veprat e tyre t'i prezantojnë në forma bashkëkohore. Çështja e formës, prandaj qëndron më pak të harxhimet materiale ose të teknologjive të përdorura, sesa tek koncepti që mund të hyjë në dialog me veprat e artistëve të tjerë. Kështu ata përfaqësojnë gjendjen e debatit mbi rymat e tyre artistike dhe të shoqërisë, respektivisht të vizioneve që ndërtohen mbi to.

"Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës" ishte në këtë pikëpamje një kontribut shumë produktiv, dhe ku u hoqën kufijtë mes hapësirës teatrore dhe hapësirës publike. Si veprë e tërësishme artistike performative, duke funksionuar sipas parimit site-specific ose in-situ, shfaqja shkaktoi fuqi të veçantë shpërthyes në skenën politike lokale. Reagimet e popullatës dhe të politikanëve ndaj komunikatave satirike për shtyp të Nezirajt krijuan nga

një shfaqje teatrore, një ngjarje në mediumet e shkruara, në internet dhe në rrjetet sociale. Teatri u bë prapë agorë dhe e gjeti kështu përsëri rolin e tij fillestar. Neziraj e kuptoi me mençuri se si t'u jap një rol politikanëve dhe si do të duhej të paraqiten ata, jo vetëm në shfaqje por edhe në kontekstin shoqëror. Dhe, secili fundja duhet të pyetet se cilin raport mes artit dhe politikës e dëshiron, dhe se si e vlerëson të tanishmen. Kufijtë ndërmjet realitetit në teatër dhe të fikcionit të provave në shfaqjen "Fluturimi..." ishin çuditërisht të rrjedhshme. Në qoftë se do të arrinte ta prezantonte shfaqjen në Evropën Perëndimore, atëherë ky kontekstualizim nuk do të mund të përsëritet. Mirëpo, po ashtu do të hidhte shumë pyetje dhe do të ngjalle po ashtu debate të frytshme sa i përket rëndësisë së pavarësisë, përkatësisht sovranitetit të Kosovës për Evropën. Të perceptuarit e Kosovës si shtet i pavarur, i cili përmes vetërefleksionit e merr fatin në duart e veta, do t'i shërbente shumë prezantimit jashtë vendit. Mirëpo, edhe pranimi i ulët, përkatësisht dashuria e paktë për flamurin verdhë-kaltër, dhe për himnin shtetëror pa tekst, tematizohen dhe bëhen të kuptueshme në shfaqje. Në kuptimin e një të ardhme të ndritur, si e vetmja e mundshme, "Fluturimi mbi Teatrin e Kosovës" është gjithsesi një shfaqje patriotike, ngaqë pikërisht këtu artistët nga Prishtina mund të punojnë në nivel të njëjtë bashkë me ata të Evropës Perëndimore. Ky lloj i produksioneve është tashmë kohë të gjatë i përditshëm në Evropën Perëndimore. Dhe në këtë mënyrë kjo shfaqje ndihmon që Kosova të bëhet një vend në zemër të Evropës. Pasqyra e një shoqërie, e cila e posedon pjekurinë për të qeshur me vetveten, krijon besueshmëri, edhe anë aspektin e ekonomisë. Njohjes së plotë të Republikës së Kosovës duhet t'i paraprijë, krahas kësaj, edhe njohja nga kokat e njerëzve në BE. Kompanitë teatrore nuk mund ta arrijnë këtë gjë vetëm dhe në shpejtësi. Mirëpo, nëse ato lihen t'i prijnë betejës vetëm, atëherë gjërat nuk do të mund lëvizin për një kohë të gjatë.

Përktheu : Rexhep Bajrami

UNIpress

## Shoqëria "Unipress" ofron vend pune si Faqosës në gazetë

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

- Të ketë përfunduar shkollën e lartë.
- Të jetë njohës shumë i/e mirë e programeve in design, photoshop.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 1 vit në shtypin e shkruar si faqosës.
- Të jetë serioz, punëtor dhe i përgjegjshëm.
- Të jetë i komunikueshëm dhe fleksibel.

Të interesuarit të paraqesin një cv pranë adresës së emailit burimetnrezore@shekulli.com.al

Ju mirepresim!

Human Resources Department

"Unipress" sh.p.k

Rr "Ismail Qemali" Tirana, Albania

E-mail: burimetnrezore@shekulli.com.al

Tel:+355 44 30 2981

Fax:+355 44 30 21 61

www.shekulli.com.al

## SHOQERIA PERMBARIMORE "E.P.S.A" SHPK KA NXJERRE NE SHITJE :

Ankandi I - **Apartment me sip. 84.4 m2**, 2+1 ,K.1, Ap.2, e ndodhur ne Rr "Prokop Myzeqari", 200 m nga Ministria e Drejtesise, Tirane. Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte **44,860 Euro**. Ankandi do te zhvillohet: ne date **05.03.2013 ne oren 16.00** ne zyrat e shoq E.P.S.A shpk te ndodhura ne Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tiranë.

Ankandi II - **Apartment me sip. 100.3 m2**, 2+1 , e ndodhur ne Selite, ngjitur me Kopshtin Zologjik. Tirane.Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte **52,640 Euro**.Ankandi do te zhvillohet ne date **06.03.2013 ne oren 16.00** ne zyrat e shoq E.P.S.A shpk te ndodhura ne Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tiranë.

Ankandi III- **Dyqan me sip. 34.2m2** e ndodhur ne Rr "Kavajes", perballe lokal "Kavaliero", Tiranë. Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte **24,960 Euro**.Ankandi do te zhvillohet ne date **06.03.2013 ne oren 16.00** ne zyrat e shoq E.P.S.A shpk te ndodhura ne Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tiranë.

Për me shume informacion mund te kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i I,  
1000 Tirana, Albania

Tel: +355 42 226 908 Fax: +355 4 237 987

## NJOFTIM

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 2, pika 9.5.3, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 17, datë 13.5.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", **Philip Morris Albania Sh.p.k.** deklaroi se duke nisur nga data **18.02.2013** do të hyjnë në fuqi çmimet maksimale të shitjes me pakicë për produktet e mëposhtme si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi i ri prej datës 18.02.2012 (përfshirë TVSh-në)
PHILIP MORRIS SLIMS 100 BOX 20 XSL	200 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS BOX 10	120 Lekë/paketë